

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e parë (1) e rregullt e Komitetit për Komunitete të Kuvendit të komunës së Dragashit, e mbajtur më 12 janar 2022, duke filluar nga ora 11:00, me këtë rend dite:

REND DITE

1. Zgjedhja e nënkryetarit nga komuniteti joshumicë i komunës së Dragashit

z.Samidin Xheladini – Përsëritje, të nderuar delegatë, z.kryetar dhe të gjithë të pranishmit. Po e hapi seancën e parë të KK-së për këtë vit kalendarik, në bazë të nenit 43 lidhur me pikën 52 pika 1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, GZ RKS 2008/28 neni 38 paragrafi 88 pika 2 të Statutit të komunës së Dragashit në bazë të cilit kryesuesi i KK-së e cakton mbledhjen e parë të rregullt të Komitetit për vitin 2022 dhe në të njëjtën kohë propozon këtë rend dite:

1. Zgjedhjen e kryesuesit të Komitetit për Komunitete

2. Zgjedhja e nënkryetarit për Komunitete të Komunës së Dragashit

Kush është për miratimin e rendit të ditës të propozuar për mbledhjen e sotme të Komitetit për Komunitete? Kush është PRO-7, KUNDËR-0, ABSTENIM-0.

z.Nedzmidin Sejdlar –Të nderuar, mendoj se keni bërë një gabim të madh sepse nuk e keni futur një pikë në rendin e ditës “Eventuale” dhe të gjithë e dimë se kjo mënyrë e punës vret demokracinë parlamentare. Duket se ne këtu po vijmë për të folur për atë që qeverisja lokale dëshiron që ne të flasim.

Pika e parë e rendit të ditës

z.Samidin Xheladini – Do ta kemi parasysh atë që thatë për këtë pikë “Eventuale”. Të nderuar, tani po kalojmë fillimisht për votimin e kryesuesit të Komitetit, a keni ndonjë propozim?

z.Merhunisa Brenoli – Të nderuar delegatë, ne nga grupi ynë parlamentar po propozojmë Miralem Rahten për kryesues të Komitetit për Komunitete.

z.Samidin Xheladini – Duke qenë se kemi vetëm një kandidat, kalojmë në votim. Kush është PRO-6, KUNDËR-1, ABSTENIM-0. Ne e përgëzojmë Miralemin për zgjedhjen e tij si kryesues i Komitetit të Komuniteteve dhe e ftojme që t'ju drejtohet shkurtimisht.

z.Miralem Rahte – Të nderuar, fillimisht dua të falënderoj kolegët e mi nga KK-ja që më kanë besuar dhe më kanë zgjedhur në këtë detyrë, si Kryesues i Komisionit për Komunitete. Me këtë

rast, përgëzoj kryetarin e komunës, të gjithë anëtarët e Komitetit, përfaqësuesit e OSBE-së dhe të gjithë të pranishmit. Faleminderit.

z.Bexhet Xheladini – Përhëndetje të gjithëve, ju uroj punë të mbarë anëtarëve në këtë mbledhje të parë të KK-së, ju uroj suksese dhe shëndet. Në bazë të kompetencave nga LVL-së nr. 03-L-040, neni 61, si dhe në bazë të UA 02/2020 MAPL për procedurën e emërimit të nënkryetarëve të komunave, në rendin e ditës së seancës së nesërme kemi zgjedhjen e nënkryetarit nga komuniteti joshumicë i komunës së Dragashit dhe bazuar në të gjitha këto, si kryetar i komunës, propozoj si kandidat të mundshëm Munezir Kukën nga shumica e komunitetit joshumicë nga fshati Restelicë. Faleminderit.

z.Nedzmidin Sejdlar – Ju deklaruat se shumica e komunitetit pakicë janë pajtuar për këtë kandidat, më intereson se ne a e dimë kush është ky njeri, a kemi biografinë e tij, cila është rruga e tij politike dhe pastaj një pyetje direkte për ju, a jeni konsultuar me ne, delegatët e pakicës këtu në Kuvend, nëse po, pse më keni diskriminuar dhe nuk më ftoni të konsultohem.

z.Samidin Xheladini – Do të aplikojmë që të gjitha masat demokratike të zbatohen.

z.Nedzmidin Sejdlar – Pyetja ime lidhet drejtpërdrejt me kryetarin, ne nuk e dimë se kush diskutohet sot këtu, kush është ky njeri, nuk e dimë se çfarë ka mbaruar etj. dhe në të njëjtën kohë ai na ka diskriminuar drejtpërdrejt dhe pa u konsultuar me neve. Fituam disa vota, aq sa janë.

z.Samidin Xheladini – Duhet të mbajmë qëndrim sot si Komitet që nesër të dalim para Kuvendit me qëndrimin tonë për të cilin kemi rënë dakord.

z.Nedzmidin Sejdlar – Nesër do të debatojmë për kandidatin por nuk e dimë kush është. A mund të na thotë kryetari sot kush është ai person, kandidati nuk është as në sallë.

z.Bexhet Xheladini – Unë kam emrin dhe mbiemrin tim, numrin personal dhe thashë që është një person nga Restelica, më është rekomanduar nga njëra parti e pakicës, jam konsultuar me partitë e pakicës por nuk jam konsultuar me partinë tuaj PG për të cilën ju kërkoj falje është lëshimi im. Për kandidatin sigurisht që më shumë do të njoftoheni në Kuvend, është e drejta juaj ta zgjidhni apo jo, detyrimi im kushtetues është që brenda një muaji të nis procedurën e propozimit dhe emërimit të nënkryetarit.

z.Miralem Rahte – Mendoj se është koha për të votuar propozimin e kryetarit, për të votuar propozimin e tij që nesër të kalojë në Kuvend. Diskutimi që ju drejtoni ndikon automatikisht në

anëtarë të tjerë të këtij komiteti. Nesër është koha kur do të mund të mendoni më në detaje. Sot po votojmë nëse do ta mbështesim apo jo propozimin e kryetarit.

z.Ventaza Esati – Përshëndetje të gjithëve, kryetari ka dhënë një propozim, unë si delegat i JGP-së e përkrah propozimin e tij, këtu unë e mbështes dhe propozoj të njëjtën gjë për nënkryetar Munezir Kukën, e njoh personalisht, është profesor i matematikës, nuk e dijë çfarë tjetër mund të ju interesojë.

z.Nedzmidin Sejdlar – Propozimin për nënkryetar në foltore e jep ekskluzivisht kryetari i Komunës në marrëveshje me delegatët. Meqë deklaroi në marrëveshje me një subjekt politikë, më intereson se cili subjekt. Ndoshta jam dakord, ndoshta kam një emër tjetër. Nëse ai ka qenë dakord me njërin subjekt, ai mund të ketë vetëm dy vota, ndërsa unë mund të kem 4 vota me tjetrin, çfarë do të bëjmë atëherë. Në të njëjtën kohë, më lejoni t'ju informoj se ju keni 7 delegatë nga komuniteti joshumicë dhe jo 6, që do të jenë anëtarë i PDK-së dhe nuk mund t'i hiqni të drejtën për të qenë gorane.

z.Bexhet Xheladini – Nuk mund t'i heq askujt të drejtën, as në fjalimin tim nuk thashë se janë 6 apo 7, ndoshta keni qenë në ëndërr kur unë kam folur. Unë thashë se jam konsultuar me dy parti politike nga komuniteti joshumicë dhe propozimi është bërë nga JGP. Kërkoj falje që kam bërë një gabim dhe nuk jam konsultuar me ju për këtë çështje. Atë që keni thënë për delegatin e PDK-së, nuk e kam përmendur në këtë foltore.

z.Nedzmidin Sejdlar – I nderuar kryetar, edhe kur flejë, flejë me sy hapur. Nuk kam kohë për të ëndërruar. Nuk thashë që edhe ju e thatë këtë, thjesht e paraqita informacionin. Është mirë që na informuat se JGP dhe Koalicioni Vakant kanë rënë dakord për një kandidat, unë e respektoj atë marrëveshje dhe do t'i mbështes pasi kanë rënë dakord.

z.Miralem Rahte – Meqenëse nuk ka komente, shkojmë me votim. Kush është pro që kjo pikë të jetë në rendin e ditës të Kuvendit të nesërm. Për ta përcjellë në Kuvend. Kush është PRO-4, KUNDËR-2, ABSTNIM-0. Kjo do të thotë se pika miratohet dhe përcillet në kuvend për shqyrtim të mëtejshëm. Nëse nuk ka diskutues të tjerë, e mbyll seancën e sotme të Komitetit për Komunitete. Ju Faleminderit.

Përgatiti:

Shërbimi i KK-së Dragash

Kryesuesi i seancës

Samidin Xheladini

Miralem Rahte